Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0805

OSHP: 2023/0830

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (LPP) në përbërjen, Isa Hasani-Kryetar, duke vendosur lidhur me ankesën e operatorit ekonomik (OE) "Mediatech & Print" Sh.P.K., (e regjistruar me numër të protokolli 805/23) dhe ankesën e OE "Infinitt" Sh.P.K (e regjistruar me numër protokolli 830/23), të parashtruara kundër Vendimit për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje telekomunikuese" me numër të prokurimit 40800-23-8779-1-3-6, iniciuar nga "Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit", nga cilësia e autoritetit kontraktues (AK), me 19.01.2024, mori:

Vendim

1 Refuzohet si e pa bazuar, ankesa OE "Mediatech & Print" Sh.P.K., e datës, 17.10.2023, nr;2023/0805, kundër" "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" AK "Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje telekomunikuese" me numër të prokurimit 40800-23-8779-1-3-6.

2. Aprovohet, si e bazuar, ankesa e OE "Infinitt" Sh.P.K, e datës 23.10.2023, nr; 2023/0830, Anulohet "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" AK-Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje telekomunikuese" me numër të prokurimit; 40800-23-8779-1-3-6, dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës së operatorit ekonomik ankues "Mediatech & Print" Sh.P.K., bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

5.Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës OE "Infinitt" Sh.P.K, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.08.2023, "Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit", duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues publikuar Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje telekomunikuese" me numër të prokurimit 40800-23-8779-1-3-6.

Me 05.10.2023, AK (me të dhëna si me sipër), përmes Njoftimit – B58, ka publikuar vendimin e tij/saj me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE "Pattern SH.P.K"

Me 10.10.2023, OE "Mediatech & Print" Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK, të datës 13.10.2023.

Si dhe me 10.10.2023, OE "Infinitt" Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK, të datës 13.10.2023.

Me 17.10.2023, Operatori ekonomik "Mediatech & Print" Sh.P.K., dhe me datën 23.10.2023 "Infinitt" Sh.P.K kanë parashtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, të cilat janë regjistruar me numër protokolli 805/23 dhe 830/23.

-Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Mediatech & Print" Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet e OE ankues: "Në arsyetimin për eliminimin të Operatorit Ekonomik "Mediatech & Print" Sh.P.K., shihet shumë qartë se Autoriteti Kontraktues- "Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit" -Komisioni vlerësues për anëtarët e komisionit nuk kane vepruar konform ligjit te LPP-së duke na eliminuar pa drejtësisht nga ky aktivitet i prokurimit pasiqe arsyetimi për eliminim të kompanisë sonë është shume i ulet dhe nuk qëndron ajo arsyeje e eliminimit . Pas publikimit në Platformën e E-Prokurimit të Formularit - B58 - Njoftim për Vendimin e

Autoritetit Kontraktues-për dhënie të kontratës, ku me kontratë ka shpërblyer OE "Pattern" SH.P.K ne me datën 05.10.2023, kemi bërë kërkesën për qasjen në dokumente dhe kemi shikuar qe ky OE i pretenduar për dhënie të kontratës nuk është ne rregull ne dokumente . Me këtë veprim Anëtarët e komisionit vlerësues të Autoritetit Kontraktues -Agjencioni Veterinarisë Dhe Ushqimit, na kane qitur në lajthitje pasiqe ne e kemi pasur katalogun e prezantuar dhe shume kjartë citohet aty mbajtëse lëvizëse ashtu e kemi pasur edhe ne e kemi pasur te ngarkuar se bashku me ofertën tonë dhe gjithashtu kemi pasur kontrata referenca ne vlere milionëshe por AK-ja dhe komisioni vlerësues këtë e ka bere me tendence për të na eliminuar nga ky aktivitet , për ti ipur kontrata firmës me çmimin shume më të lartë se ne. Të gjitha këto veprime anti ligjore të Zyrtarëve-Anëtarëve të Komisionit të "Agjencinë Veterinarisë dhe Ushqimit" për ta shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik të preferuar nga Anëtarët e komisionit të AK-së – "Pattern" SH.P.K E gjithë kjo është bërë, pasiqë çmimi i ofertës së këtij Operatori Ekonomik është shumë më i lartë se çmimi i ofertës tonë, "Mediatech & Print" Sh.P.K.,. Autoriteti Kontraktues gjatë ri-vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të Nenit 59, të LPPsë dhe Nenit 41 të RROUPP-A01, pasi që vlerësimin e ofertave nuk e ka bërë duke u bazuar në gjendjen faktike dhe dëshmive të cilat i ka pasur te prezantuara në ofertën tonë. Autoriteti Kontraktues AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT ka bërë shkelje të Nenit 6 të LPP-së , pasi që këtë aktivitet të prokurimit nuk ka arritur ta përfundojë për më shumë se disa muaj , si dhe tani shpërblen me kontratë Operatorin Ekonomik "Pattern" SH.P.K i cili ka dorëzuar ofertën me çmimin më të lartë. Autoriteti Kontraktues "Agjencinë Veterinarisë dhe Ushqimit" ka bërë shkelje të Nenit 7 të LPP-së , pasi që gjatë ri-vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë Operatorët Ekonomik në mënyrë të njëjtë. Këtë e dëshmon fakti që Autoriteti Kontraktues "Agjencinë Veterinarisë Dhe Ushqimit" nuk ka kërkuar që të verifikohen apo te dërgojnë sqarime shtese për të sqaruar katalogun për produktin e prezantuar dhe KETO dokumentet e kompanisë sonë –MEDIATECH&PRINT SHPK. Autoriteti Kontraktues AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT ka bërë shkelje të Nenit 60 të LPP-së , pasi qe nuk na ka shpallur fitues ne si OE me çmimin më të ulet dhe i përgjegjshëm ashtu siç është cekur ne Dosjen e tenderit : IV.6 Kriteret për dhënie të kontratës Kontrata do ti ipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar: Tenderin e përgjegjshëm, me çmimin më të ulët AK-ja ketu ka bere shkelje ligjore duke vendosur të ipet kontrata OE me të shtrejt kështu duke keqpërdore paranë publike dhe fondet publike. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese AK gjithashtu nuk e ka përdorur këtë Nen të LPP-së ku ka mundur të dërgojë kërkesë për sqarimin e tenderit pasiqe ky gabim sipas AK-se nuk e devijon ofertën tonë andaj ka mundur të sqarohet duke na dërguar kërkesën për sqarimin e tenderit dhe ne normalisht se ju kishim përgjigjur pozitivisht kërkesës suaj sepse ne e posedojmë tere këtë material dhe kemi aplikuar me çmime të arsyeshme për këtë arsyeje edhe jemi dalur OE me çmimin me të lire dhe sipas specifikave teknike , por ju pa na dërguar fare sqarime direkt keni vendosur te na eliminoni për arsyen ti ipet kontrata një operatori ekonomik me cmimin shume me te larte se kompania jone kështu duke e keqpërdor edhe buxhetin e shtetit. Ne shume mire e kemi dërguar katalogun ashtu siç është kërkuar Mbajtëse Lëvizëse për TV. Pasi qe AK nuk ka vepruar drejt dhe prapë na ka diskriminuar edhe pas dërgimit të Kërkesës për Rishqyrtim ne jemi detyruar qe te bëjmë ankesën ne OSHP , ne me date 10.10.2023 kemi bere kërkesën për rishqyrtim ku kemi japur gjitha faktet dhe dëshmitë qe AK ka vlerësuar jo drejte dhe ne mënyrë diskriminuese , kjo e dëshmon fakti ku ky AK me date 13.10.2023 ka kthyer përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim duke na refuzuar . Andaj ne kemi shfrytëzuar të drejtën tone ligjore për të bere ankesë ne OSHP me date 17.10.2023 Ne pika te shkurtra ju njoftojmë se AK ka bere shkelje ligjore : Neni 1 Qëllimi Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 72 Dokumentacioni dhe

informacioni shtese Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik –(RRUOPP A01), që ka qene në fuqi prej datës 01.02.2021 deri me datën 01.11.2022, janë: Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "Mediatech & Print" Sh.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 72 të LPP si dhe duke kërkuar të aprovohet ankesa jonë ne tersi si e bazuar dhe lënda të kthehet ne në rivlerësim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Infinitt" Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se "AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për tenderin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/1--042 1 ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/1--237, Ligjin Nr. 05/1--068 dhe Ligjin Nr. 05/1--092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik. Me 05.10. autoriteti kontraktues ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK ku ka rekomanduar për kontrate OE Pattern sh.p.k.Me 05.10. kemi kërkuar qasje ne dokumentet zyrtare dhe qasja na është lejuar nga AK me 06.10.Nga dokumentet e pranuara dhe shqyrtimin e tyre konstatojmë se AK ka rekomanduar për kontrate OE te papërgjegjshëm i cili nga katalogët e dorëzuara nuk plotëson specifikimet teknike si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit për pozicionin 3. Projektor. OE i rekomanduar për kontrate për pozicionin 3 ka ofertuar me projektor model Benq MVV536. Ky produkt nuk plotëson specifikimet teknike pasiqe modeli i lampes është kërkuar 5J.J9V05.001 ndërsa modeli MW536 ka lamp me part nurnber 5J.JN605.001. Modeli i projektorit Benq te cilin ne kemi ofertuar MW632ST ka modelin e lampes PN 5J.J9V05.001. N përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim AK fare nuk ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor. Megjithëse devijim i Vogël është mos plotësim i specifikimeve teknike dhe shpërblimi me kontratë për OE i cili nuk plotëson të gjitha specifikimet teknike përben favorizim. Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate nuk plotëson specifikimet teknike për produktin nr.4 ne specifikacion mbajtës lëvizës për TV. Produkti i ofertuar 650605 60-100" Ultra-large Telescopic Display TV Cart nuk ka dimensionet si ne kërkesë si dhe pesha bartëse, po ashtu ngjyra është kërkuar e zezë ndërsa OE ka ofruar ngjyre hiri.OE i rekomanduar për kontrate po ashtu rezulton i papërgjegjshëm pasiqe nuk ka dorëzuar ndaras siç janë kërkuar deklaratën e liferimit dhe garancionit si ne kërkesat nr. 3 dhe 4 ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit mirëpo ne një deklarate ka përfshirë të dy deklaratat edhe pse AK ka kërkuar ndaras dy deklarata ne dy kritere te ndryshme nr 3 dhe 4 po ashtu deklarata nuk i drejtohet Agjencisë se Ushqimit dhe Veterinës por Ministrisë se Ekonomisë."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "Infinitt" Sh.P.K, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së si dhe 20, 41 te UOPP-së duke kërkuar të aprovohet ankesa si e bazuar dhe te kthehet lënda në rivlerësim.

Përgjigje e Autoritet Kontraktues në Kërkesën për rishqyrtim të Operatorve ekonomik ankues.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE-ve (vlen për të dy OE-të) se AK ka bere shkeljen e Nenit 1 të LPP-se është i pabaze sepse AK ka respektuar këtë nen dhe autoriteti kontraktues si qellim ka të siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese ne Republikën e Kosovës duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiçen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet qe do të përmbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionert e punëve dhe organet publike qe zhvillon, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, ne aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kane të bëjnë me fondet dhe/ ose burimet e tilla. Kështu që ne

këtë aktivitet të prokurimit kane ofertuar pese operatore ekonomik të gjithë janë vlerësuar sipas LPP-së dhe ju si operator ekonomik pra "INFINITT" SH.P.K jeni i përgjegjshëm por keni çmimin me të lartë ndërsa ju operatori ekonomik MEDIATECH&PRINT SHPK nuk jeni të përgjegjshëm edhe pse keni çmimin me të ulët sepse specifikacionin teknik te dosjes se tenderit gjegjësisht aneksi 1 nuk e keni plotësuar kërkesën e specifikacionit teknik numër 4 Mbajtës lëvizës për TV sepse ne specifikacionin teknik e keni paraqitur mbajtësin për vendosje ne muri të TV-se e ndërsa ne specifikacion teknik ne dosjen e tenderit është kërkuar të jetë "Mount type: LCD/LED TV mobile floor stand". Lidhur me pretendimin ankimor te OE-ve (vlen per OE MEDIATECH&PRINT SHPK) se AK ka bere shkeljen e Nenit 6 te LPP-se është i pabaze sepse AK ka respektuar këtë nen dhe sipas paragrafit 1 të këtij neni ne si autoritetet kontraktuese, jemi të obliguara që të sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit që do të thotë qe ju si OE keni qene i papërgjegjshëm edhe pse keni çmimin me të ulët dhe autoriteti kontraktues ka shpërblyer me kontrate operatorin tjetër me radhe të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE-ve (vlen për të dy OE-te) se AK ka bere shkeljen e Nenit 7 te LPP-se është i pabaze, sepse si AK kemi respektuar këtë nen dhe autoriteti kontraktues i ka trajtuar operatorët ekonomik ne mënyrë të barabarte dhe jo-diskriminuese dhe ka vepruar ne mënyre transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutoje asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit ne një mënyrë qe redukton apo eliminon konkurrencën ne mes te operatorëve ekonomik ose që diskriminon ne dem ose në të mire të një ose më shume operatoreve ekonomik. Ne këtë rast ne si AK kemi pranuar pese oferta dhe të gjitha ofertat janë vlerësuar sipas LPP-së dhe nuk kemi diskriminuar asnjë nga operatorët ekonomik por të gjithë janë trajtuar të barabarte si ata të përgjegjshmit po ashtu edhe ata te papërgjegjshëm qe janë dhe nuk kemi futur asnjë operator ekonomik ne lajthitje, kështu qe autoriteti kontraktues ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin me të ulët. Sa i përket pretendimit (vlen për OE “MEDIATECH&PRINT” SHPK) qe kjo procedure e prokurimit prej fillimit e deri ne vendim është përgatitur për ta shpërblyer me kontrate operatorin ekonomik me çmimin me të larte është i pabaze sepse nga pese OE qe kane dorëzuar ofertat, tre prej tyre janë të përgjegjshëm dhe dy janë të papërgjegjshëm dhe prej tre të përgjegjshmëve kemi shpërblyer operatorin ekonomik me çmimin me të ultë të përgjegjshëm, dhe lusim nga operatoret ekonomik (vlen për OE MEDIATECH&PRINT SHPK) të kenë kujdes gjate paraqitjes së pretendimeve të pabaza ne kërkesat për rishqyrtim duke ndërhy ne profesionalizmin e zyrtareve apo anëtareve të komisioneve të vlerësimit, gjithashtu vlen të ceket qe ky tender nuk është ri-vlerësuar siç është than nga OE MEDIATECH&PRINT SHPK.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE-ve (vlen për "INFINITT" SH.P.K) se AK ka bere shkeljen e Nenit 28 te LPP-se është i pabaze, sepse si AK kemi respektuar këtë nen dhe sipas paragrafit 2 të këtij neni kemi përpiluar specifikimet teknike ne atë mënyrë që ato të jene ne përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa me të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Ne si autoritet kontraktues nuk kemi hartuar specifikime teknike qe favorizojnë ose diskriminojnë një ose me shume operatore ekonomik dhe për kite arsye kemi pranuar edhe pese ofertues.

Ju si OE sa i përket pozicionit 4 nuk jeni as për se afërmi me dimensionet që keni ofruar pra dimensionet e pozicionit 4 ju që keni ofruar janë 683 x 1685 × 1094 ndërsa operatori ekonomik i cili është shpërblyer me kontrate ka ofruar dimensionet 1245 x 755 x 2315 përveç ngjyrës qe nuk është e zeze por ngjyre argjendi e që sipas paragrafit 4 te nenit 59 te LPP-se Autoriteti

kontraktues do te konsideroje një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjale është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsideroje një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit e fjale, ose (i) përmban vetëm devijime të vogla qe nuk mund te shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit; me kusht qe, çfarëdo devijimi i tillë te kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, kështu qe ka pak devijime te vogla nga karakteristika por që nuk janë të kuantifikueshme dhe nuk e shkaktojnë ndryshime materiale.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE-ve (vlen për të dy OE-të) se AK ka bere shkeljen e Nenit 59 te LPP-se është i pabaze, sepse si AK kemi respektuar ketë nen dhe sipas paragrafit 1 Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ne ketë rast autoriteti kontraktues ka vepruar sipas këtij paragrafi dhe neni, ne këtë rast MEDIATECH&PRINT SHPK nuk jeni të përgjegjshëm edhe pse keni çmimin me të ulët sepse specifikacionin teknik të dosjes se tenderit gjegjësisht aneksi 1 nuk e keni plotësuar kërkesën e specifikacionit teknik numër 4 Mbajtës lëvizës për TV sepse ne specifikacionin teknik e keni paraqitur mbajtësin për vendosje ne muri të TV-së e ndërsa në specifikacion teknik ne dosjen e tenderit është kërkuar të jete "Mount type: LCD/LED TV mobile floor stand". Ndërsa tek OE "INFINITT" SH.P.K sa i përket pozicionit 4 nuk jeni as për se afërmi me dimensionet qe keni ofruar pra dimensionet e pozicionit 4 ju qe keni ofruar janë 683 x 1685 x 1094 ndërsa operatori ekonomik i cili është shpërblyer me kontrate ka ofruar dimensionet 1245 x 755 x 2315 përveç ngjyrës qe nuk është e zeze por ngjyre argjendi e qe sipas paragrafit 4 te nenit 59 te LPP-se Autoriteti kontraktues do të konsideroje një tender si te përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjale është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit, Pavarësisht nga e me parshamja, autoriteti kontraktues mund të konsideroje një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit e fjale, ose (ü) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tille të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gate vlerësimit dhe krahasimit t tenderëve, kështu qe ka pak devijime të vogla nga karakteristika por qe nuk janë të kuantifikueshme dhe nuk e shkaktojnë ndryshime materiale pra edhe ju si OE qe jeni pak me i shtrenjte se sa OE qe është shpërblyer me kontrate keni pak devijime të vogla tek pozicioni 4 por që nuk janë të kuantifikueshme dhe nuk e shkaktojnë ndryshime materiale. Sa i përket deklaratave te cilat janë cekur nga OE "INFINITT" SH.P.K qe është shkruar Ministria Ekonomisë është gabim teknik qe nuk e ndryshon asgjë dhe nuk shkakton ndonjë ndryshim material.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE-ve (vlen për të dy OE-te) se AK ka bere shkeljen e Nenit 60 te LPP-së është i pabaze, sepse si AK kemi respektuar ketë nen dhe sipas paragrafit 1 te këtij neni Autoriteti kontraktues do tija jap kontratën publike operatorit ekonomik qe ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me të ulët që ne këtë rast edhe është shpërblyer operatori ekonomik me çmimin me të ulet i përgjegjshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE-ve (vlen për OE MEDIATECH&PRINT SHPK) se AK ka bere shkeljen e Nenit 72 te LPP-s është i pabaze sepse AK ka respektuar këtë nen dhe sipas paragrafit 3 Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do te aplikohet vetëm

për dokumentet ekzistenca e te cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund te verifikohet ne mënyre objektive ne këtë rast ju keni dërguar katalogun e pozicionit 4 që ne mënyre substanciale ndryshon nga ajo qe është kërkuar ne specifikacionin e detyrueshëm teknik të dosjes se tenderit. Ndërsa kur keni cekur qe mund te keqpërdoret buxheti i shtetit nëse kontrata i jepet operatorit ekonomik me çmimin më te larte është i pabaze sepse ne njoftimin për kontrate pika 11.1.8) Vera e parashikuar e kontratës është 6,000.00 e që ne si AK kemi shpërblyer me kontrate qe ka çmimin e ofertuar 4,375.00 € qe do të thotë qe nuk ka kurrfarë keqpërdorimi të buxhetit të shtetit.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE-ve (vlen për "INFINITT" SH.P.K) se AK ka bere shkeljen e Nenit 20 (me rregulloren e re neni 19) te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik - (RRUOPP A01) është i pabaze, sepse si AK kemi respektuar këtë nen dhe sipas paragrafit 19.4 përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jene të qarta, sakta dhe precize dhe duhet te mos paraqet kufizime te pa arsyeshme, ne mënyre qe te mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet te përkufizohen ne mënyre që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës se mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara. Kështu qe ne si AK kemi respektuar këtë nen dhe specifikimet teknike janë të qarta dhe nuk kemi bere kufizime te pa arsyeshme ne mënyrë qe të kufizohet konkurrenca.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE-ve (vlen për të dy OE-të) se AK ka bere shkeljen e Nenit 41 (me rregulloren e re neni 40) Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik - (RRUOPP A01) është i pabaze, sepse si AK kemi respektuar këtë nen dhe sipas paragrafit 40.7 "Ne pajtueshmëri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet te kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike te parashtruara ne dosje te tenderit duke mos u larguar ne mënyre thelbësore nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

"Largime dhe kufizime thelbësorë janë ato të cilat: (i) Dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes se tenderit; dhe/ ose (üi) Afektojnë parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës; dhe/ose (tiii) Kufizon te drejtat e AK ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës; dhe/ ose (iv) Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e te cilëve janë ne pajtueshmëri me rregullat, Kështu qe AK ka vepruar sipas nenit 40 paragrafi 40.7 dhe nuk ka bere dallime esenciale dhe nuk është larguar ne mënyre thelbësore duke i respektuar te gjitha pikat e përmendura më larte.

Ne baze të kësaj që u tha me lartë, AK AUV konsideron se kërkesat për ri shqyrtim janë në kundërshtim me B58 Njoftimi mbi vendimin e AK AUV dhe sipas nenit 108/A, paragrafi 10.1, refuzon kërkesat e propozuara për shqyrtim si të pabaza."

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 26/10/2023 dhe 28/10/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 805/23 dhe 830/23, ndërsa me datë 27/10/2023 dhe 29/10/2023 janë dorëzuar raportet e ekspertit me nr. 2023/0805 dhe 2023/0830 me rekomandimet si në vijim:

Për raportin Nr. 805/23 Eksperti rekomandon "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues MEDIATECH & PRINT te refuzohet si e pabazuar.

Për raportin Nr. 830/23 Eksperti rekomandon "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar për lenden 805/23 rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE "Mediatech & Print" Sh.P.K., nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, ndërsa për ankesën me nr.830/23 AK nuk është pajtuar me rekomandimin e eksperti shqyrtues ndërsa OE "Infinitt" Sh.P.K. është pajtuar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE "Mediatech & Print" Sh.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0805 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore - "OE ankues "MEDIATECH & PRINT" shpk; OE ankues pretendon se është eliminuar pa te drejte kur AK i ka dhënë sqarimet e eliminimit duke saktësuar se ne Dosje të tenderit është kërkuar Mbajtës për Televizor i dyshemesë me peshe mbajtëse maksimale 100kg kurse OE ankues ka ofertuar ne katalogun e tij mbajtësin lëvizës për montim ne mur. Eksperti ka shqyrtuar dokumentacion të cilën OE ankues e ka dorëzuar me rastin e aplikimit për këtë procedure prokurimi dhe ka pare qe ne katalog behet fjale për mbajtës lëvizës të murit dhe jo të dyshemesë ashtu siç është kërkuar me DT. Pra, ne foton ne vijim janë kërkesat e AK ne dosje të tenderit: Pra, siç edhe shihet ky pretendim është i PA BAZUAR ngase përveç se nuk është plotësuar kërkesa për mbajtës televizori të dyshemesë po ashtu nuk është plotësuar edhe pozicioni tjetër specifikues ai i cili thotë qe pesha mbajtëse duhet të jete deri ne 100kg, të cilën OE ankues e ka ofertuar me vetëm deri ne 40kg siç shihet edhe ne katalogun e tyre, detaj të cilin komisioni vlerësues nuk e ka përshkruar ne letrën dërguar operatorit.

Lidhur me pretendimet e OE "Infinitt" Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0830 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimore – 1: "OE ankues pretendon se OE i propozuar për kontratë nuk e ka përmbushur kërkesën e DT mbi mbajtësen e TV e cila është kërkuar të jetë me ngjyre të zezë kurse OE i propozuar për kontratë "PATTERN" shpk ka ofertuar me ngjyre hiri. Ky pretendim është i bazuar sipas ekspertit pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar me ofertën për këtë procedure nga OE. Pra shohim pjese të katalogut nga "PATTERN" shpk ku shihet ngjyra SILVER dhe jo BLACK siç është kërkuar.Ne vijim po paraqesim katalogun e OE ankues INFINITT shpk ku shihet qe ngjyra është e zeze për mbajtësen e TV.

Përgjigje në pretendimin ankimore – 2: "Pretendimi tjetër ankimor ka te beje me pozicionin e llampes se projektorit me të cilën ka ofertuar OE i propozuar për kontratë PATTERN shpk ku OE ankues pretendon qe as këtë pike nuk e plotëson sipas kërkesave të DT. ne vazhdim po shohim kërkesën ne bazë të DT e cila është kërkuar si ne vijim me nr. të pjesës specifike: Kurse po të shohim katalogun e ofruar nga OE ankues INFINITT shpk vërehet që produkti i ofruar është konform sa i përket kësaj pike të kërkuar me DT. Edhe ky pretendim konsiderohet si i bazuar duke pare faktet dhe katalogët e ofruara".

Përgjigje në pretendimin ankimore – 3: "OE i rekomanduar për kontratë po ashtu rezulton i pa përgjegjshëm pasi qe nuk e ka dorëzuar ndaras siç janë kërkuar deklaratën e liferimit dhe të garancionit si ne kërkesat si ne kërkesat nr.3 dhe 4 ne aneksin 1 të dosjes se tenderit mirëpo ne një deklaratë ka përfshirë të dy deklaratat edhe pse AK ka kërkuar ndaras të dy deklaratat ne dy

kritere të ndryshme nr.3 dhe 4 po ashtu deklarata nuk i drejtohet Agjencisë se Veterinarisë dhe Ushqimit por Ministrisë se Ekonomisë .”

Eksperti pas shikimit të dokumentacionit konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar ngase edhe pse janë ngarkuar ne një fajll dokumentet brenda janë të nënshkruara dhe vulosura veç e veç, përveç gabimit teknik ku brenda teksti emërtohet Ministria e ekonomise ne vend te Agjensionit te veterinarise dhe ushqimit, e cila është shkruar ne rregull tek titulli i dokumentit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mediatech & Print” Sh.P.K., janë të pa bazuara ndërsa pretendimet e operatoreve ekonomik ankues “Infinitt” Sh.P.K janë të bazuara, dhe lënda kthehet ne rivlerësim.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar vendimin e AK të datës 05.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje telekomunikuese” me numër të prokurimit "40800-23-8779-1-3-6" pasi që konsiderohet se AK nuk ka vepruar drejtë dhe konform dispozitave ligjore dhe lenden ta kthej ne rivlerësim. Andaj duke pas parasysh të gjitha

shkresat e lëndës rekomandimin e ekspertit shqyrtues i cili është mjaft i detajuar, Paneli Shqyrtues konstaton se AK nuk ka vepruar sipas kërkesave të Dosjes se tenderit lidhur me mbajtësen e TV, pozicionin e llempes së projektorit, të cilat OE i propozuar për kontratë nuk i ka plotësuar sipas DT. AK është e obliguar të trajtoj në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të gjithë operatoret ekonomik gjatë zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji."

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi se operatorit ekonomik ankues "Mediatech & Print" Sh.P.K., i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës konform nenit 31 pika 5 të LPP-së.Ndërsa të kthehen mjetet e deponuara në emër të tarifes tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Infinitt" Sh.P.K konform nenit 31 pika 4 dhe 6 të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT, AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT**
- OE - **MEDIATECH & PRINT SH.P.K., " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: